

Legjionaret/ Demtohet Sorrentino, Ujkani titullar

nga AlbaniaSoccer

E martë, 19 Nentor 2013 22:01



Sajmir Ujkani do të rikthehet titullar. Rastesia e ka bërë që Sorrentino të demtohet dhe portieri shqiptar të rimarrë vendin që humbi sezonin e kaluar. Lajmi bëhet i ditur nga mediat italiane, si dhe gjen konfirmim nga portieri i Palermos, Stefano Sorrentino. Në ndeshjen me Rexhinën ai pësoi një dëmtim muskular dhe tani i duhet të mbyllë për kohë pjesën e parë të sezonit. Për Ujkanin kjo është një mundësi e artë për të bindur trajnerin dhe të gjithë ata që e ndjekin që në janar të vlejë me tepër dhe nëse do të jete në skuadër të gjej një ekip më të mirë për të luajtur rregullisht. Ujkani prej muajsh ishte harruar në stol dhe kjo e bëri që të humbiste kombetaren e De Biasit.